



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 1024/22; 1025/22; 1026/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) sipas nenit 98, 99, lidhur me nenin 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP, në përbërje Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Agon Ramadani-Anëtare dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, duke vendosur lidhur me kërkesën për "paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik" e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2, të LPP e parashtruar me 28.10.2022 nga Komuna e Dragashit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), ndaj Operatorëve Ekonomik (OE) si në vijim: N.T.P "Acvilla" Prishtinë, N.T.SH "Nazi Travel" në Prishtinë, dhe N.T.SH "Bedi Com" Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me lëndë djegëse (dru ahu ose bungu)" me numër të prokurimit 621-22-8644-111, me 08.05.2023, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar kërkesa e datës 28.10.2022 (Protokolli 1024/2022;1025/22;1026/22) e Komunës së Dragashit, e parashtruar në cilësinë e AK, për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga OE, sipas nenit 99 paragrafi 2 të LPP, kurse operatorët ekonomik: N.T.P "Acvilla" Prishtinë (me numrin unik të regjistrimit 810506991), N.T.SH "Nazi Travel" Prishtinë (me numrin unik të regjistrimit 810094201) dhe N.T.SH "Bedi Com" Prishtinë (me numrin unik të regjistrimit 810941478) diskualifikohen nga aktiviteti i prokurimit "Furnizim me lëndë djegëse (dru ahu ose bungu)" me numër të prokurimit 621-22-8644-111 dhe të njëjtëve ju ndalohet pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik për periudhën kohore në kohëzgjatje 6 muaj, duke filluar nga data 08.05.2023 deri me datën 08.11.2023.
2. Urdhërohet AK, respektivisht Komuna e Dragashit, që ta bëjë konfiskimin e sigurisë së tenderit për të gjithë OE, me të dhëna si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.
3. OSHP ka të drejtë që ta revokoj masën e shqiptuar, nga dita kur dhe nëse OSHP njoftohet me aktin e organeve kompetente, sipas të cilit vërtetohet se vepra e kualifikuar sipas paragrafit 1, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk është kryer.

A r s y e t i m

Me 28.10.2022, Komuna e Dragashit në cilësinë e AK, ka dorëzuar në OSHP kërkesë për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP, ndaj OE: N.T.P “Acvilla” Prishtinë, N.T.SH “Nazi Travel” Prishtinë dhe N.T.SH “Bedi Com” Prishtinë, për paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatorët ekonomik, sikurse parashihet me nenin 99 par 2 të LPP.

Lidhur me kërkesën e cituar si më sipër AK ka deklaruar se operatorët ekonomik në rastin konkret, kanë dorëzuar një Listë me kontrata për furnizim me dru, e cila i referohet njoftimit për kontratë. Në këtë rast, AK e ka konsideruar të nevojshme dhe ka kërkuar sqarime plotësuese nga OE, përfshirë dhe Deklaratën nën Betim, sipas së cilës kërkohet që OE të deklarojnë se i përmbushin kërkesat e nenit 65 dhe 69 pika 4.2 të LPP. Megjithatë, operatorët ekonomik në këtë rast nuk kanë ofron kurrfarë dëshmie në kuadrin e kohës së kërkuar, duke e nënkuptuar faktin se operatorët ekonomik (me të dhëna si më sipër) janë tërhequr nga nënshkrimi i deklaratës së cituar. Lidhur me këtë AK, ka theksuar se, cituar: “...secili operator ekonomik i cili merr pjesë në një aktivitet të prokurimit me rastin e dorëzimit të ofertës duhet të nënshkruaj Deklaratën nën Betim ku deklaron se përmbush kërkesat e nenit 65 dhe 69 pika 4.2 të LPP” duke kërkuar nga OSHP që në harmoni me legjislacionin të merren masa ndaj këtyre operatorëve ekonomik.

OSHP me 28.10.2022, ka njoftuar të gjithë OE (me të dhëna si më sipër) lidhur me kërkesën e AK, nga të cilët N.T.P “Acvilla” dhe N.T.SH “Nazi Travel” nuk kanë kthyer përgjigje. Mirëpo me 31.10.2022, N.T.SH “Bedi Com” ka dërguar një përgjigje duke e njoftuar OSHP se, cituar: “Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ne nuk kemi pranuar kërkesë për sqarim apo dokumente shtesë qysh aludon autoriteti kontraktues K.K. Dragash. Dëshmi që ne nuk kemi pranuar kërkesë për sqarim janë fotot *print-screen* të e-prokurimi për aktivitetin në fjalë.”

Paneli shqyrtues pas analizimit të akteve dhe veprimeve të palëve dhe pretendimeve reciproke të tyre, konstatoj se në lënda në rastin konkret përmban dokumente dhe shkresa të mjaftueshme, mbi bazën e të cilave Paneli ka të drejtë të vendos në aspektin meritore pa prezencën e palëve, sikurse parashihet kjo me nenin 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave dhe fakteve të lëndës, ka konstatuar se është jo kontestues fakti se operatorët ekonomik (me shënime si më sipër) kanë marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, por njëherësh konsiderohet se është jo kontestues edhe fakti se të njëjtit janë tërhequr nga rrjedha e mëtejme dhe përmbushja e detyrimeve të cilat parashihen si të tilla në kuptim të LPP. Sipas Panelit tërheqja e OE si në këtë rast, konsiderohet si një qasje jo serioze e cila i krijon dëme në ushtrimin e rregullt të detyrave të AK. Plotësimi i dokumenteve të kërkuara nga AK, është e domosdoshme së paku në kuptim të nenit 64 (Dëshmitë e kërkesave) nenit 65 (Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve) dhe nenit 69 (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale) të LPP.

Paneli Shqyrtues me detyrë zyrtare ka shikuar për të dhëna në platformën elektronike të prokurimit (e-prokurimi) dhe vëren se vërtetë figuron kërkesa e AK për sqarim e datës 16.09.2022, e cila i ishte drejtuar OE N.T.SH “Bedi Com” dhe se nuk qëndron shpjegimi i operatori ekonomik “Bedi Com” i cili ka pohuar se gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ne nuk kemi pranuar kërkesë për sqarim apo dokumente shtesë qysh aludon autoriteti kontraktues.

Bazuar në pohimet e AK, në veprimet e OE dhe natyrën e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret, Paneli Shqyrtues konsideron se është fakt jo kontestues se OE janë tërhequr nga plotësimi i detyrimeve të tyre, të cilat shprehimisht parashihet si të tilla në kuptim të dispozitave të cituara si më sipër të LPP. Prandaj objektivisht lind detyrimi i OSHP, që ta zbatoj dispozitën e cituar si më sipër të LPP, sipas së cilës kërkohet që operatorët ekonomik në rastin konkret të diskualifikohen nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të prokurimit dhe (sipas gjykimit të pavarur të këtij Paneli) të njëjtëve ju ndalohej e drejta për të marrë pjesë në aktivitet e prokurimit publik në periudhën kohore në kohëzgjatje 6 muaj, duke filluar nga data 08.05.2023 deri me datën 08.11.2023. Megjithatë, Paneli Shqyrtues sqaron se masa e diskualifikimit, e shqiptuar dhe shpjeguar si më sipër, mund te revokohet nga momenti kur dhe/ose nëse OSHP njoftohet nga autoritetet kompetente se vepra e cituar dhe e komunikuar sipas paragrafit 1, të dispozitivit të këtij vendimi, nuk është kryer.

Prandaj nisur nga të lartcekurat Paneli shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar/e e Panelit Shqyrtues



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;

- AK-Komuna e Dragashit
- |OE: N.T.P "Acvilla", N.T.SH "Nazi Travel" dhe N.T.SH "Bedi Com"
- Arhivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe;